

**AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“A.K. ALBANIA CONSTRUCTION” sh.p.k.**

Sot, me date 09 Mars 2023, palet si me poshte:

- Z. Klejdi Jaup, Shtetas Shqiptar, lindur ne Vlore, me 09.02.1990 me atesi Barjam, banues ne Tirane, mbajtes i dokumentit te identitetit me numer: J00209061S, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Ne perputhje me Ligjin Nr. 9901 date 14.04.2008, “Per tregetarët dhe Shoqerite Tregetare” (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723 date 3.5.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit” (i ndryshuar) kemi vendosur te themelojme nje Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar te emeruar “A.K. ALBANIA CONSTRUCTION” sh.p.k (me poshte referuar si “Shoqeria”), duke neneshkruar kete Akt Themelimi, Aktiviteti i kesaj Shoqerie do te rregullohet nga Statuti i saj, i cili eshte pjese perberese e ketij Akti Themelimi.

Neni 1

Emri i Shoqerise eshte “A.K. ALBANIA CONSTRUCTION” sh.p.k.

Neni 2

Selia e Shoqerise ndodhet ne Adresen: “Njesia Administrative nr. 5, Rr. Komuna e Parisit, Kompleksi Kika 2, Godina 11, Kati 6, Tirane”.

Shoqeria ka te drejte te hape dege dhe filiale, zyra perfaqesimi, ne te gjithë vendin, brenda ose jashte territorit te vendit, gjate aktivitetit te saj.

Neni 3

Kohezgjatja e aktivitetit te Shoqerise do te jete e pakufizuar, duke filluar qe prej dates se regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Biznesit (QKB).

Neni 4

Objekti i veprimtarise se Shoqerise eshte si vijon:

- Tregtimi me shumicë dhe pakicë, si dhe importimi dhe eksportit i artikujve shtëpiake, pajisje elektroshtëpiake, pajisjet elektrike dhe artikuj higjieno – sanitarë;
- Shitblerja e pasurive të patundshme (në çfarëdo forme, përfshirë tokat dhe zonat e ndërtimit), si dhe reklamimin, urbanizimin, zhvillimin. Marrja me qira, mirëmbajtja, administrimi dhe restaurimi i pasurive të paluajtshme;
- Për sa kohë që konsiderohet e nevojshme ose e dobishme nga organet drejtuese për arritjen e qëllimit të biznesit, shoqeria mund të kryejë operacione të letrave me vlerë, pasurive të patundshme, tregtare, industriale, leasing si përdorues, si një autor i faktoringut, operacione financiare te cdo lloji.
- Shoqeria gjithashtu mund te marre pjese në investime të qëndrueshme në shoqeri ne shoqëri ekzistuese, të cilat kane aktivitate te njejta ose te peraferta me objektin e shoqerise te percaktuar në këtë statut.

Neni 5

Kapitali fillestar i Shoqerise eshte 50 000 (pesedhete mije) leke dhe i ndare ne 1 pjese (kuote) me vlere nomiale 50000 (pesedhete mije) leke.

Kapitali zoterohet nga ortakët e shoqerise si me poshte:

- Z. Klejdi JAUP, i cili zoteron 1 kuote te Shoqerise ose 50 000 (pesedhete mije) leke qe perfaqesojne 100 % te kapitalit te Shoqerise.

Ortakët e Shoqerise mund te vendosin te rrisin kapitalin e Shoqerise ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi dhe me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Shoqerise. Detyrimet e ortakëve te shoqerise kundrejt Shoqerise do te mbulohet vetem me pjesen e kapitalit te paguar prej tyre.



Neni 6

Shoqeria vepron nen rregjimin e prones private dhe merr persiper vetes te drejttat dhe detyrimet kontraktore dhe jashtekontraktore.

Shoqeria eshte e organizuar ne organet e meposhtme:

-Asambleja e Pergjithshme;

-Administratori;

Kompetencat e Asmblese se Pergjithshme si dhe te administratorit te Shoqerise jane te parashkruara ne Statutin e Shoqerise.

Neni 7

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet te behet publike permbajtja e tyre per te tretet, e te gjitha akteve dhe dokumenteve qe jane percaktuar si te tilla nga administratori i shoqerise.

Neni 8

Mardheniet e punes rregullohen nepermjet kontrates se punes dhe legjislacionit te punes ne fuqi. Shoqeria merr persiper te respektojne rregullat ne fuqi te punesimi dhe te punesuarit jane te detyruar qe ta respektojne Statutin e kesaj Shoqerise dhe rregullat e brendshme te saj. Te punesuarit duhet te pergjigjen per demet qe shkaktojne kesaj Shoqerise me veprimet dhe mosveprimet e tyre.

Neni 9

Ne rast se Shoqeria do te mbyll aktivitetin e saj per cdo lloj arsye, Asambleja e Jashtezakonshme e Ortakeve te Shoqerise, percakton menyren e likuidimit, emerone nje ose me teper likuidatore dhe pergatit te gjitha dokumentet e nevojshme per c'registrimin e saj nga Qendra Kombetare e Biznesit.

Neni 10

Kontrolli mbi veprimtarine e Shoqerise si dhe gjithe aktivitetin e Shoqerise i besohet nje eksperti kontabel. Ky ekspert do te emerohet dhe qendroje ne detyre sipas parashikimeve qe ben ligji per esperitet dhe mund te rizgjidhet. Asambleja e Pergjithshme cakton edhe shperblimin perkates kur nuk ka norma te vecanta ligjore.

Neni 11


Viti financiar fillon ne 1 Janar dhe mbaron ne 31 dhjetor te secilit vit. Perjashtim, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise prane Qendres Kombetare te Biznesit dhe mbyllet me 31 dhjetor. Administratori merr masat me qellim hartimin e bilanceve, rezultateve ekonomike te fitimeve apo humbjeve dhe inventarizimin. Pas analizimit te ceshtjeve te mesiperme si dhe shlyerjen e detyrimeve, te ardhurat e tjera do ti kalojne ortakeve te Shoqerise.

Neni 12

Akti i Themelimit eshte hartuar ne 4 kopje origjinale ne gjuhen shqipe.

Per sa eshte shprehur ne kete Akt Themelimi, i referohemi ligjit 9901, date 14.04.2008 "Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" (i ndryshuar).

ORTAKU I VETEM
E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"A.K. ALBANIA CONSTRUCTION" sh.p.k.


Emer Mbiemer Nenshkrimi